INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS

USHTRIMI I DETYRËS SË PRESIDENTIT PËRTEJ GJASHTË MUAJVE

Kufiri kushtetues dhe vazhdimësia e Presidencës



"ANALIZË E SHKURTËR"

TETOR 2026

USHTRIMI I DETYRËS SË PRESIDENTIT PËRTEJ GJASHTË MUAJVE

Kufiri kushtetues dhe
vazhdimësia e Presidencës

"ANALIZË E SHKURTËR"

TETOR 2026

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Aktgjykimi në rastet e bashkuara KO256/26 dhe KO258/26 ka sqaruar statusin e Kuvendit dhe kushtetutshmërinë e vendimit për zgjedhjen e Qeverisë, si dhe ka përcaktuar 6 tetorin si afatin përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit. Ky zhvillim e bën më të ngutshme çështjen e bazës së ushtrimit të përgjegjësive presidenciale pas skadimit të kufirit gjashtëmujor.[1]



Sipas vlerësimit të kësaj analize, rizgjedhja e saj kryetare e Kuvendit më 9 shtator nuk e rinis këtë periudhë.

Neni 90(3) vendos shprehimisht një kufi gjashtëmujor për ushtrimin e kësaj detyre. Për periudhën e nisur nga Albulena Haxhiu më 4 prill 2026, gjashtëmujori plotësohet më 4 tetor. Sipas vlerësimit të kësaj analize, rizgjedhja e saj kryetare e Kuvendit më 9 shtator nuk e rinis këtë periudhë.

Afati për zgjedhjen e Presidentit dhe kufiri për ushtrimin e detyrës kanë funksione të ndryshme. Gjykata i ka përcaktuar shpërndarjen e Kuvendit dhe zgjedhjet e parakohshme, si pasojën të moszgjedhjes së Presidentit deri më 6 tetor. Aktgjykimi nuk përcakton shprehimisht efektin e rizgjedhjes së Kryetares mbi gjashtëmujorin, ndërsa Kushtetuta nuk përcakton shprehimisht as një pasues tjetër në rolin e Ushtruesit të Detyrës së Presidentit pas afatit gjashtë-mujor, e as bartësin e kompetencave presidenciale nëse procesi dështon. Skadimi i gjashtëmujorit, në vetvete, nuk nënkupton pavlefshmërinë automatike të çdo akti pasues.

KDI kërkon që Kuvendi dhe subjektet parlamentare t'i përqendrojnë përpjekjet në zgjedhjen dhe betimin e Presidentit deri më 4 tetor. Sidoqoftë, institucionet apo palët tjera të autorizuara duhet njëkohësisht të kërkojnë sqarim nga Gjykata Kushtetuese lidhur me efektin e zgjedhjes së Kryetarit në raport me afatin gjashtë mujor të U.D. Presidentit; ushtrimit të kompetencave pas skadimit; si dhe statusit të akteve do t'u jepte institucioneve. Kjo do t'u ofronte institucioneve dhe partive parlamentare një bazë të përbashkët veprimi, përpara se këto paqartësi të kthehen në konteste për vendime konkrete.

1 KO256/26 dhe KO258/26, aktgjykimi i datës 29 shtator 2026, paragrafët 217 dhe 221–226 dhe pikat II, V e VI të dispozitivit.

1. GJENDJA INSTITUCIONALE DHE RËNDËSIA E 4 TETORIT

Albulena Haxhiu mori detyrën e Ushtrueses së Detyrës së Presidentes më 4 prill 2026, pas përfundimit të mandatit të Presidentes Vjosa Osmani. Kjo, pra, është pikënisja e periudhës aktuale të ushtrimit të detyrës së Presidentit. Gjashtë muaj kalendarikë nga kjo datë do të përmbyllen më 4 tetor 2026.[2]

Pas dështimit për zgjedhjen e Presidentit dhe zgjedhjeve të parakohshme të 7 qershorit, legjislatura e re nisi seancën konstituive më 6 gusht. Më 9 shtator, Albulena Haxhiu u rizgjodh kryetare e Kuvendit, ndërsa më 13 shtator ajo e shpalli Kuvendin të konstituuar, pa u zgjedhur nënkryetari nga PDK-ja. Po atë ditë, Kuvendi e votoi Qeverinë e udhëhequr nga Albin Kurti. Avancimi i këtyre proceseve e ka zhvendosur vëmendjen te zgjedhja e Presidentit dhe te koha e mbetur e ushtrimit të përkohshëm të detyrës.[3]

Në rastet KO72/26 dhe KO74/26, të 25 marsit 2026, Gjykata e ndërlidhi fillimin e procedurës për zgjedhjen e Presidentit, në rrethanat e një Kuvendi të shpërndarë dhe ende të pakonstituuar, me konstituimin e tij dhe përfundimin e procedurës brenda 60 ditësh. Aktgjykimi i shtatorit e ka saktësuar zbatimin e këtij rregulli kur konstituimi vonohet, duke precizuar që kalimi i afatit 30-ditor e vë në rrjedhje afatin për zgjedhjen e Presidentit, respektivisht Qeverisë. Për rastin aktual, pikënisja është 8 gushti dhe përfundimi 6 tetori.[4]

Marrëveshja e 31 gushtit ndërmjet LVV-së dhe LDK-së për kandidaturën e Bekim Sejdiut u kundërshtua nga të paktën gjashtë deputetë të LDK-së, ndërsa më 14 shtator vetë Sejdiu u tërhoq. Ndonëse LDK-ja e kishte lidhur vazhdimin e bisedimeve me vendimin e Gjykatës për konstituimin, ende nuk ka pasur lëvizje konkrete.

Më 14 dhe 15 shtator, deputetë të PDK-së iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për konstituimin e Kuvendit dhe zgjedhjen e Qeverisë. Kërkesat u bashkuan dhe Gjykata vendosi më 23 shtator, derisa vendimi i plotë u publikua më 29 shtator 2026.[5]

Në aktgjykim, Gjykata konstatoi se Kuvendi është konstituuar në shkelje të afatit 30-ditor, por megjithatë legjitimoi vendimin e 13 shtatorit për zgjedhjen e Qeverisë, duke konstatuar që i njëjti nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën (nenin 95). Gjykata po ashtu përcaktoi se afati 60-ditor për zgjedhjen e Presidentit ka filluar më 8 gusht dhe përfundon më 6 tetor 2026. Sipas paragrafit 226, nëse Presidenti nuk zgjidhet brenda këtij afati, Kuvendi shpërndahet në bazë të Kushtetutës dhe zgjedhjet e parakohshme duhet të mbahen brenda 45 ditësh nga shpërndarja.[6]

Edhe pse ky përcaktim e zgjidh afatin dhe pasojën për Kuvendin, vet aktgjykimi nuk e sqaron shprehimisht çështjen e kufirit gjashtëmujor të ushtrimit të detyrës së Presidentit, në rast të dështimit për zgjedhjen e Presidentit dhe shkuarjes në zgjedhje. Në këtë kontekst, parashtruesit e kishin përmendur rrezikun e tejkalimit të gjashtëmujorit në arsyetimin e kërkesës për masë të përkohshme; por që Gjykata nuk kishte ofruar ndonjë sqarim për të. Për periudhën e nisur më 4 prill, 4 tetori vjen dy ditë para afatit për zgjedhjen e Presidentit. Prandaj, çështja e kompetencave presidenciale lind që në këtë interval dhe bëhet edhe më e rëndësishme nëse pas 6 tetorit duhet të shpallen zgjedhje të reja.[7]

2 Presidenca, njoftimi zyrtar i marrjes së detyrës, 4 prill 2026. Njoftimi zyrtar.

3 Radio Evropa e Lirë, raportimet e seancave të 9 dhe 13 shtatorit 2026. Më 13 shtator u shpall konstituimi pa nënkryetarin e PDK-së dhe u votua Qeveria me 62 vota 'për'. Për kushtet juridike të konstituimit, shih rastin KO124/25, paragrafët 132, 133 dhe 145. Seanca e 9 shtatorit; Zhvillimet e 13 shtatorit.

4 Rastet KO72/26 dhe KO74/26, paragrafët 161-162 dhe 182-185. Aktgjykimi. KO256/26 dhe KO258/26, paragrafët 219-224 dhe pika VI e dispozitivit.

5 Radio Evropa e Lirë, 15 shtator 2026, raportimi për kërkesën kundër zgjedhjes së Qeverisë dhe përgjigjja e Gjykatës për bashkimin e kërkesave. Kërkesa për Qeverinë; Konfirmimi i bashkimit të kërkesave. KO256/26 dhe KO258/26, paragrafi 19 për vendimmarrjen më 23 shtator dhe faqja hyrëse, e datës 29 shtator 2026. Publikimi në Gazetën Zyrtare më 30 shtator 2026.

6 KO256/26 dhe KO258/26, paragrafët 217 dhe 221–226; pikat II, V dhe VI të dispozitivit.

7 KO256/26 dhe KO258/26, paragrafi 69 për pretendimin e parashtruesve dhe paragrafët 218-228 për vlerësimin e Gjykatës. Dispozitivi nuk përmban përcaktim të shprehur për zgjatjen e gjashtëmujorit të nenit 90(3).

2. KUADRI KUSHTETUES DHE STATUSI I USHTRUESIT TË DETYRËS SË PRESIDENTIT

Neni 90 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës rregullon shprehimisht mungesën e përkohshme të Presidentit. Paragrafët 1 dhe 2 parashikojnë kalimin vullnetar të përgjegjësive te Kryetari i Kuvendit ose konstatimin nga Kuvendi të paaftësisë së përkohshme. Kjo situatë dallon nga vakanca pas përfundimit të mandatit, dorëheqjes ose shkarkimit, duke qenë se paaftësia e përkohshme nuk e përfundon vetvetiu mandatin e Presidentit.[8]

Paragrafi 3 përcakton qartazi se "Posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj." Neni 9(3) i Ligjit për Presidentin e përsërit këtë kufi dhe nuk shton një radhë pasimi pas skadimit të tij.[9]

Kryetari i Kuvendit, në bazë të nenit 90, ushtron përkohësisht përgjegjësitë e Presidentit dhe mbetet ushtrues detyre. Presidenti i zgjedhur ka mandat pesëvjeçar, i cili fillon me betimin para Kuvendit, sipas nenit 87. Prandaj, zgjedhja si Kryetar i Kuvendit dhe marrja e përgjegjësive presidenciale janë dy baza juridike të ndryshme.



8 Kushtetuta, nenet 87, 90 dhe 91. Kushtetuta.
9 Ligji nr. 03/L-094 për Presidentin, neni 9, paragrafi 3 Ligji për Presidentin.

3. KUPTIMI I KUFIRIT GJASHTËMUJOR

3.1 Teksti dhe qëllimi i kufizimit

Formulimi i paragrafit 3 të nenit 90 "nuk mund të ushtrohet" ka karakter ndalues në raport me ushtrimin e detyrës së Presidentit, përtej afatit të përcaktuar. Gjashtëmujori kufizon kohëzgjatjen e ushtrimit të një posti dhe nuk është vetëm afat për kryerjen e një veprimi procedural. Kushtetuta nuk parashikon shprehimisht zgjatje për shkak të mungesës së konsensusit, dështimit të zgjedhjes së Presidentit ose shpërndarjes së Kuvendit.

Në rastin KO97/10, të 22 dhjetorit 2010, Gjykata Kushtetuese e trajtoi nenin 90 në rrethanat pas dorëheqjes së Presidentit Fatmir Sejdiu. Në paragrafin 19, ajo e lidhi kufirin gjashtëmujor me garantimin që Kuvendi ta zgjedhë bartësin e postit të Presidentit. Prandaj, ky arsyetim mbështet zbatimin e kufirit edhe gjatë vakancës, përtej rasteve të paaftësisë së përkohshme. Megjithatë, duke qenë se objekti i atij rasti ishte ushtrimi i njëkohshëm i funksionit partiak, Gjykata nuk përcaktoi aty rregullimin e kompetencave pas skadimit të gjashtëmujorit.[10]

Kufizimi ka edhe qëllim demokratik. Kryetari i Kuvendit zgjidhet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve, ndërsa Presidenti përmes procedurës së posaçme të nenit 86. Vazhdimi i pakufizuar i ushtrimit të detyrës do të lejonte që shumica e nevojshme për zgjedhjen e Kryetarit ta zëvendësonte në praktikë procedurën e zgjedhjes së Presidentit. Në fakt, leximi i ndërlidhur i neneve 4, 16, 67, 86 dhe 90 të Kushtetutës e mbështet gjashtëmujorin si garanci pikërisht kundër këtij anashkalimi dhe relativizimi të normës.[11]

3.2 Vazhdimësia institucionale dhe çështjet që kërkojnë sqarim

Argumenti për vazhdimin e detyrës mbështetet te nevoja për funksionimin e pandërprerë të institucioneve. Mungesa e një pasuesi të përcaktuar shprehimisht mund të pengojë veprime të domosdoshme, përfshirë shpalljen e zgjedhjeve që do të mundësonin daljen nga kriza. Sipas kësaj pikëpamjeje, rregullimi i paplotë i vakancës së zgjatur mund të arsyetojë një vazhdim kalimtar të përgjegjësive. Sidoqoftë, pesha e këtij argumenti është më e madhe për veprimet e domosdoshme sesa për vazhdimin e pakufizuar të të gjitha kompetencave presidenciale.

Ky argument i vazhdimësisë institucionale bazohet deri diku edhe në arsyetimin e Gjykatës në KO72/26 dhe KO74/26, si dhe në paragrafin 224 të aktgjykimit të shtatorit. Megjithatë, vendosja e afatit të 6 tetorit për zgjedhjen e Presidentit nga Gjykata, nuk u shoqërua me një përcaktim shprehimor për zgjatjen e ushtrimit të detyrës pas 4 tetorit. Një lexim i tillë i nënkuptuar do të duhej të pajtonte nevojën për vazhdimësi me nenin 90(3) dhe KO97/10, duke saktësuar bazën, kohëzgjatjen dhe kufijtë e autoritetit kalimtar. Megjithatë, vazhdimësia duhet të shihet si arsye për zgjidhje kushtetuese në kohë, dhe nuk duhet të shndërrohet vetvetiu në autorizim që bartësi ta zgjasë detyrën. [12]

Edhe afatet korrigjuese që Gjykata caktoi për konstituimin e Kuvendit në vitin 2025 nuk përkthehen automatikisht në zgjatje të gjashtëmujorit. Pra, praktika për afatet ndihmon për të dalluar shkeljen nga pasojat e saj, por pa e zgjidhur çështjen në esencë.[13]

10 Rasti KO97/10, paragrafët 6-10 dhe 19. Aktgjykimi.
11 Kushtetuta, nenet 4, 16, 67(2), 86(4,5) dhe 90(3). Dispozitat kushtetuese.
12 Rastet KO72/26 dhe KO74/26, paragrafët 117-118, 157, 164 dhe 179-185. Për kufirin shih KO97/10, paragrafi 19. Aktgjykimi. KO256/26 dhe KO258/26, paragrafi 224. Për dallimin ndërmjet afatit të zgjedhjes dhe kufirit të ushtrimit të detyrës, shih Kushtetutën, nenet 82(1)(3) dhe 90(3).
13 Rasti KO124/25, paragrafët 140-145 dhe dispozitivi. Aktgjykimi.

3.3 Rizgjedhja e Kryetarit dhe periudhat e veçanta të vakancës

Teza për rinisjen e afatit e lidh ushtrimin e detyrës me mandatin e Kryetarit të ri të Kuvendit. Këtë qëndrim e kanë shprehur dhe mbrojtur publikisht akterë të ndryshëm, ndërsa vetë Presidenca ka folur për kalimin e detyrës te Kryetari i ri deri në zgjedhjen e Presidentit.

Sidoqoftë, lidhja ndërmjet dy funksioneve përcakton bartësin e përgjegjësive, por nuk krijon automatikisht gjashtë muaj të rinj brenda së njëjtës vakancë. Dështimi i zgjedhjes së Presidentit dhe shpërndarja e Kuvendit ndryshojnë gjendjen parlamentare, ndërsa vakanca e pozitës së Presidentit vazhdon. Një rinisje e afatit me çdo Kryetar të ri do të mundësonte përsëritjen e ushtrimit të përkohshëm përmes cikleve zgjedhore, pa zgjedhur President sipas nenit 86.

Megjithatë, kufiri nuk duhet paraqitur si ndalim që i njëjti person ta ushtrojë sërish detyrën në një vakancë tjetër. Në sqarimin e 1 prillit 2011 për KO29/11, Gjykata u pyet për pikënisjen e gjashtëmujorit, duke pasur parasysh shërbimin e mëparshëm të Jakup Krasniqit. Ajo konfirmoi se Kosova kishte ushtrues detyre nga 31 marsi 2011, pas publikimit të aktgjykimit që rrëzoi zgjedhjen e Behgjet Pacollit.

Gjithashtu, duke qenë se sqarimi i vitit 2011 nuk jep një rregull të plotë për mbledhjen e periudhave të ushtrimit të detyrës. Për rastin aktual, mosrinisja automatike me rizgjedhjen e Kryetares mbetet interpretimi më i mbështetur në leximin sistematik të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, efekti përfundimtar i këtyre rrethanave mbetet për t'u përcaktuar nga Gjykata, në rast të parashtrimit të një kërkese të re nga palët e autorizuara qoftë nëpërmjet kërkese të re për sqarim të vendimit të fundit apo nëpërmjet hapjes së një rasti të ri.



4. ÇËSHTJET E PAZGJIDHURA PAS SKADIMIT DHE PASOJAT INSTITUCIONALE

4.1 Baza e ushtrimit të detyrës dhe mungesa e një pasuesi të shprehur

Kufiri gjashtëmujor e vendos institucionin e Presidentit përballë një pyetjeje që Kushtetuta nuk e rregullon shprehimisht: si do të ushtrohen kompetencat presidenciale nëse Presidenti i ri ende nuk është zgjedhur dhe betuar?

Moszgjatja e njëanshme e afatit bazohet te teksti dhe qëllimi i nenit 90(3). Megjithatë, mungesa e një mekanizmi të shprehur pas skadimit krijon, pasiguri për personin që mund t'i ushtrojë ligjërisht kompetencat presidenciale dhe për kufijtë e veprimeve të tij. Kjo pasiguri prek si vendimet e përditshme kushtetuese, ashtu edhe hapat për daljen nga një krizë e re potenciale zgjedhore.

Për më tepër, Neni 90 nuk përcakton që, pas gjashtë muajve, përgjegjësitë i kalojnë automatikisht një nënkryetari të Kuvendit, Kryeministrit ose çfarëdo institucioni tjetër. Neni 67(8) rregullon zëvendësimin e Kryetarit në funksionin parlamentar në rast mungese ose pamundësie, por vetëm në kuadër të funksionimit parlamentar. Gjithashtu, skadimi i gjashtëmujorit nuk e përfundon vetvetiu mandatin edhe të Kryetares së Kuvendit, meqenëse dy funksionet kanë baza të dallueshme.

Përfundimi i gjashtëmujorit nuk e shpërndan vetvetiu Kuvendin. Për rastin aktual, Gjykata e ka lidhur shpërndarjen me dështimin për ta zgjedhur Presidentin deri më 6 tetor, sipas nenit 82(1)(3). Deri në atë afat, detyrimi parlamentar për zgjedhjen e Presidentit mbetet në fuqi. Nëse ai dështon, lind nevoja për shpalljen e zgjedhjeve parlamentare, kompetencë presidenciale sipas nenit 84(3). Prandaj, në këtë drejtim, efekti i shpërndarjes së Kuvendit dhe autoriteti për aktin që shpall zgjedhjet janë dy çështje që duhen dalluar.[14]

4.2 Kompetencat që rrezikohen

Me zgjedhjen e Qeverisë më 13 shtator, caktimi i mandatarit për atë Qeveri tashmë është kryer. Paqartësia dhe pasiguria për autoritetin e ushtrueses së detyrës pas gjashtëmujorit prek vendimet e mëvonshme, veçanërisht emërimet kushtetuese, shpalljen eventuale të zgjedhjeve dhe përgjegjësitë në përfaqësimin e jashtëm e në siguri. Edhe pse Qeveria, gjykatat dhe administrata kanë vazhdojnë kompetencat e tyre, sipas përcaktimeve ligjore respektive, pengesa konkrete shfaqet kur veprimi i një institucioni kërkon edhe një akt të nxjerrë nga Presidenti.[15]

Në anën tjetër, as veprimtaria ligjvënëse nuk bllokohet domosdoshmërisht në tërësi. Neni 80(5) i Kushtetutës parashikon që ligji konsiderohet i shpallur pa nënshkrimin e Presidentit nëse ai nuk merr vendim për shpalljen ose kthimin brenda tetë ditësh nga marrja. Zbatimi kërkon dokumentimin e dorëzimit dhe respektimin e çdo ndalese ligjore ose mase të Gjykatës. Megjithatë, ky mekanizëm nuk mund të shtrihet si rregull i përgjithshëm edhe tek dekretet apo vendimet tjera të Presidentit.[16]

Zgjedhja e një rruge tjetër për vazhdimësinë pa bazë të qartë do të krijonte precedent për krizat e ardhshme. Rinisja e gjashtëmujorit me çdo Kryetar të ri do ta ulte koston politike të vonesës në zgjedhjen e Presidentit. Në anën tjetër, një ndërprerje e pazgjidhur e kompetencave mund ta bënte edhe daljen nga kriza më të vështirë, sidomos nëse kërkohet shpallja e zgjedhjeve të reja. Kjo e arsyeton ndërhyrjen parandaluese para skadimit.

14 KO256/26 dhe KO258/26, paragrafi 226; Kushtetuta, nenet 82(1)(3), 84(3) dhe 86(6). Burimi zyrtar.
15 Kushtetuta, nenet 84, 95, 104, 109, 114, 126 dhe 131. Kompetencat kushtetuese.
16 Kushtetuta, neni 80(2) dhe (5). Për rastet e kontestimit parlamentar, shih edhe nenin 43(2) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Rregulli i shpalljes.



4.3 Aktet e marra gjatë periudhës së kontestuar

Nëse ushtrimi i detyrës vazhdon pas gjashtëmujorit pa bazë kushtetuese të konfirmuar nga Gjykata Kushtetuese, aktet e nxjerra rrezikojnë të kundërshtohen për mungesë kompetence, pra akte që në doktrinë kushtetuese quhen si veprime ultra vires. Sidoqoftë, pavlefshmëria e tyre nuk mund të shpallet paraprakisht në tërësi. Vlerësimi kushtetues i akteve, në bazë të legjislacionit në fuqi, kërkon aktin konkret, rrugën përkatëse të kontrollit dhe përcaktimin e pasojave kohore.

Neni 116(3) lejon që Gjykata t'i përcaktojë efektet e vendimit ndryshe nga rregulli i përgjithshëm i hyrjes në fuqi në ditën e publikimit. Në KO325/25, të vendosur më 28 janar 2026, Gjykata përjashtoi efektin prapaveprues në rrethanat e atij rasti, për siguri juridike. Edhe sqarimi në KO29/11 dalloi rrëzimin e zgjedhjes së Presidentit nga efektet e mëparshme. Këto raste tregojnë rëndësinë e vlerësimit të pasojave, por assesi nuk garantojnë mbrojtjen e akteve të një ushtruesi detyre pas gjashtë muajve.[17]

17 Kushtetuta, neni 116(3); Rasti KO325/25, paragrafi 147 dhe pika III e dispozitivit; sqarimi KO29/11, paragrafi 10. Aktgjykimi.

5. NEVOJA PËR SQARIM KUSHTETUES PARA SKADIMIT TË AFATIT

Pas aktgjykimit KO256/26 dhe KO258/26, kërkesa për sqarim duhet të përqendrohet te marrëdhënia ndërmjet afatit të 6 tetorit për zgjedhjen e Presidentit dhe kufirit gjashtëmujor që, përmbyllet më 4 tetor. Përgjigjja do të përcaktonte bazën e veprimit të institucioneve gjatë këtij intervali dhe, nëse zgjedhja dështon, gjatë kalimit në zgjedhje të parakohshme.

Një referim i ri duhet të plotësojë kushtet e nenit 113 dhe të lidhet me një çështje brenda juridiksionit të Gjykatës. Jurisprudenca e Gjykatës, gjegjësisht rasti KO79/18, e ka kufizuar mundësinë që nenet 84(9) dhe 112 të përdoren si bazë për pyetje të përgjithshme jashtë atij juridiksioni, prandaj përgatitja e kërkesës duhet të sigurojë që çështja të mund të shqyrtohet në merita.[18]

Kur ekziston një konflikt real kompetencash ndërmjet institucioneve, ai duhet dokumentuar dhe paraqitur nga pala e autorizuar. Në varësi të objektit të pranueshëm, një referim mund të kërkojë sqarimin e efektit të rizgjedhjes mbi gjashtëmujorin, të autoritetit për veprimet dhe vendimet e U.D. Presidentit pas skadimit dhe të pasojave për aktet konkrete të kontestuara.

Krahas kësaj, mundësi tjetër për t'u shqyrtuar është një kërkesë e përqendruar për sqarimin e aktgjykimit të përbashkët KO256/26 dhe KO258/26. Kjo kërkesë duhet ta lidhë nevojën për përgjigje me zbatimin e afatit të 6 tetorit dhe të pasojës së shpërndarjes që Gjykata ka përcaktuar, duke shmangur trajtimin e saj si një rrugë të garantuar për shqyrtimin e çdo pyetjeje të re kushtetuese.Kryetarja e Kuvendit, në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Presidentes, mund të kërkojë që Gjykata të vlerësojë mundësinë e sqarimit të këtyre çështjeve: a ka përcaktimi i 6 tetorit ndonjë efekt mbi kufirin e nenit 90(3); mbi çfarë baze dhe me çfarë kufijsh mund të ushtrohen përgjegjësitë presidenciale pas 4 tetorit; dhe kush ka autoritetin për shpalljen e zgjedhjeve nëse Kuvendi shpërndahet për moszgjedhjen e Presidentit. Formulimi duhet të kërkojë përgjigje për kompetencën dhe zbatimin e aktgjykimit.

Një mundësi e tillë do të bazohej në praktikën e Gjykatës Kushtetuese e cila ka ndodhur në rastin KO 29/11, ku pas Aktgjykimit të 30 marsit 2011, Kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi paraqiti më 31 mars 2011 kërkesë për sqarimin e pasojave të Aktgjykimit, ndërsa kërkesa dhe pyetje të lidhura me të njëjtin aktgjykim u paraqitën edhe nga Presidenca dhe Qeveria.[19]

Vetëm një ditë pas, në sqarimin e 1 prillit 2011, Gjykata iu përgjigj pyetjeve të lidhura me pasojat e aktgjykimit, duke theksuar se nuk mund të dilte jashtë objektit të tij. Kjo praktikë mbështet shqyrtimin e mundësisë së një kërkese të ngushtë për sqarim; pa krijuar nevojën për një rast dhe interpretim të ri. Në rastin konkret, një përgjigje e Gjykatës menjëherë pas skadimit të afatit të 4 tetorit do të mund të sqaronte paraprakisht pasojat kushtetuese dhe rrjedhën institucionale që duhet të ndiqet, duke shmangur kështu një situatë të re të pasigurisë lidhur me kompetencat e institucioneve dhe hapat e mëtejshëm kushtetues. Sidoqoftë, edhe nëse Gjykata e konsideron çështjen e nenit 90 jashtë kufijve të aktgjykimit të shtatorit, duhet vlerësuar referimi i veçantë sipas nenit 113. Pranueshmëria e secilës rrugë mbetet për t'u vlerësuar nga Gjykata.[20]

Afërsia e të dy afateve e arsyeton paraqitjen dhe trajtimin me përparësi të kërkesës përkatëse, me synim sqarimin deri më, ose menjëherë pas 4 tetorit dhe me respektimin e afateve procedurale të zbatueshme.

18 Rasti KO97/10, paragrafët 11-16; Rasti KO79/18, paragrafët 65-78 dhe 83, vendosur më 21 nëntor dhe publikuar më 3 dhjetor 2018. Aktvendimi për papranueshmëri.

19 KO29/11, Sqarim i aktgjykimit, 1 prill 2011, paragrafët 1–6 për kërkesat dhe procedurën. Burimi zyrtar.

20 KO29/11, Sqarim i aktgjykimit, paragrafët 8–9 dhe 16; KO79/18, paragrafët 65–78, për kufijtë e juridiksionit. Precedenti i sqarimit nuk garanton pranueshmërinë e një kërkese me objekt të ri. Burimi zyrtar.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Aktgjykimi i shtatorit ka përcaktuar detyrimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit deri më 6 tetor dhe pasojën e dështimit. Për kufirin e ushtrimit të detyrës, KDI vlerëson se neni 90(3) dhe arsyetimi në KO97/10 mbështesin moszgjatjen e njëanshme të periudhës aktuale dhe mosrinisjen automatike të saj me rizgjedhjen e Kryetares. Marrëdhënia ndërmjet dy afateve dhe autoriteti për nxjerrjen e akteve nga U.D. Presidentja potencialisht pas afatit gjashtëmujor mbeten çështjet që kërkojnë përgjigje nga Gjykata Kushtetuese.

Kjo përgjigjje duhet ta ruajë peshën e kufirit kushtetues dhe njëkohësisht të parandalojë mungesën e një bartësi të ligjshëm të kompetencave presidenciale.

Në funksion të adresimit të gjetjeve të këtij punimi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), ofron rekomandimet, si në vijim:

- Kuvendi dhe subjektet parlamentare të sigurojnë pa vonesë kandidaturat, mbështetjen dhe përmbylljen e suksesshme të seancës, respektivisht zgjedhjen e Presidentit. Kjo duhet të bëhet me synim zgjedhjen dhe betimin e Presidentit të ri, mundësisht para 4 tetorit, në mënyrë që të shmangen pasiguritë eventuale për autoritetin e mëtejshëm të ushtrueses të detyrës së Presidentit, pas 6 tetorit, si afat përfundimtar për zgjedhjen e Presidentit të ri.

- Kryetarja e Kuvendit, në cilësinë e ushtrueses së detyrës së Presidentes, apo edhe palët e tjera të autorizuara, të shqyrtojë menjëherë paraqitjen e një kërkese të përqendruar për sqarimin e lidhjes ndërmjet dy afateve dhe të zbatimit të pasojave të aktgjykimit KO256/26 dhe KO258/26. Kërkesa të adresojë autoritetin e ushtrueses të detyrës së President pas 4 tetorit dhe kompetencën për shpalljen potenciale të zgjedhjeve, nëse Presidenti nuk zgjidhet deri më 6 tetor.

- Gjykata Kushtetuese t'i trajtojë me përparësi dhe në procedurë të përshpejtuar kërkesat përkatëse. Vlerësimi i pranueshmërisë dhe, kur kushtet plotësohen, i meritave apo çfarëdo mase tjetër, duhet të marrë parasysh afërsinë e 4 dhe 6 tetorit, si dhe rrezikun për aktet që mund të kërkohen për shpalljen e zgjedhjeve të reja.

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

Sweden
Sverige